



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.:1701/24 Datë: 20.08.2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 127 të mbajtur më datë 12.08.2024 Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë për periudhën **pesë (5) vjeçare**, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2029):
 - *Informatikë në Biznes MSc 120 R, me kuotën maksimumi 60 studentë për vit akademik;*
- II. Numri i studentëve zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- V. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimeve me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Informatikë në Biznes MSc 120 ECTS (R)	Edmond Beqiri Gentiana Gega

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit në Universiteti “Haxhi Zeka” në Pejë AKA ka organizuar vizitat me ekspertët ndërkombëtarë të akreditimit: Miklos Hoffmann, Andrea Serban dhe Arnoldas Solovjovas.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

Për programin e studimit; Informatikë në Biznes MSc 120 ECTS, vizita me ekspertin ndërkombëtar të akreditimit është organizuar më 24.06.2024 të cilët në raport përfundimtar kanë konstatuar se nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht pesë (5) dhe Substancialisht dy (2) fusha të standardeve të akreditimit.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 127-të, të mbajtur më datë 12.08.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin relevant të Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit “Haxhi Zeka” në Pejë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë